

GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, SEZONI 2024/2025

(java e 44, deri më 03.11.2024)

Të dhëna javore

Gjatë javës së dyzetë e katërt të vitit 2024 (nga 28.10-03.11.2024), në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar 47 raste ($I=2,6/100.000$ banorë) të të prekurve nga gripi/sëmundjet e ngjashme me gripin, 11,9% më shumë se javën e kaluar (42). Krahasuar me javën e dyzetë e katërt të vitit të kaluar (45), është regjistruar një rritje prej 6,8%%, ndërsa sa i përket modelit për 14 sezonet e fundit (55) është regjistruar një rënie prej 14,3%.

Të sëmurët e kësaj jave janë regjistruar në Kumanovë – 25, Tetovë – 12, Prilep- 4, Strumicë – 3, Kavadar – 3, Shkup dhe Gostivar nga 1.

Sa i përket moshës, tek grupmosha 15-64 janë regjistruar 27 persona, tek grupmosha mbi 65 vjet – 8 dhe tek fëmijët nga 5-14 janë regjistruar 15 raste.

Deri më javën e 44 gjithsej janë regjistruar 195 raste ($I=10,6/100.000$) banorë.

Gjatë javës së 44 të vitit 2024, pranë laboratorit të virologjisë të ISHPRMV-së kanë arritur 16 materiale për analiza laboratorike për gripin, nga të cilat 11 nga mbikëqyrja SARI, paralelisht të analizuar edhe për grip edhe për COVID-19 dhe të gjitha kanë rezultuar negative për prani të virusit të gripit.

Gjithsej deri më tani janë analizuar 84 materiale, e që të gjitha kanë rezultuar negative për prani të virusit të gripit.

Vaksinimi kundër gripit

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i shëndetit publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- Gratë shtatzëna dhe
- Punonjësit shëndetësorë.

Për sezonin 2024/2025, Ministria e shëndetësisë siguroi 70 000 doza të vaksinë katërvalente falas për këto kategori të popullatës. 10.000 doza doza shtesë të vaksinës katër valente janë siguruar përmes donacionit nga PIVI (Partnership for Influenza Vaccine Introduction).

Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2024/2025 filloi në 21.10.2024 dhe zbatohet në Shtëpitë e shëndetit dhe/ose Qendrat e shëndetit publik me Njësitë e tyre rajonale. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes www.vakcinacija.mk.

Sipas Drejtorisë për Shëndetësi Elektronike nga fillimi i vaksinimit e deri në mbylljen e këtij raporti gjithsej janë vaksinuar 51.487 persona që bëjnë pjesë në kategoritë e grupeve të cënueshme të popullatës.

2.600 vakcina komerciale shtesë janë siguruar nga ana e Qendrave të shëndetit publik si vakcina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e shëndetit publik dhe Njësitë e tyre rajonale.

Sa i përket vaksinave komerciale, deri më tani janë vaksinuar 1.209 persona.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë vaksinuar gjithsej 52.687 persona me vakcina falas dhe komerciale.

RAJONI EVROPIAN

*Burimi: <https://erviss.org/>

Raporti për gjendjen me gripin në Rajonin Evropian për javën e 42 të sezonit të ri 2024/2025 tregon se aktiviteti i virusit të gripit është në nivel messezonal, që është karakteristike për këtë periudhë të vitit.

Shkalla e morbiditetit të gripit (ILI) dhe /ose infeksioneve respiratore akute është rritur mbi nivelet bazë në 3 nga 20 vende të rajonit evropian të OBSH-së.

SARS-COV-2 vazhdon të qarkullojë në rajon, me një numër relativisht të ulët të infeksioneve. Grupmoshat më të mëdha vazhdojnë të përbëjnë numrin më të madh të rasteve.

Në nivel rajonal, pranimet në spital dhe në repartet e kujdesit intensiv si pasojë e SARS-COV-2 janë në nivele stabile.

Holanda ka raportuar një rast të Influenza B/Yamagata të regjistruar gjatë javës së 42. Po vijon hetimi epidemiologjik.

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse

Instituti i Shëndetit Publik